

Bibël për fëmijët paraqet

Jona dhe Peshku i Madh



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: Jonathan Hay

Përkthyer nga: Arianit & Valbona Iljazi

Adaptuar nga: Mary-Anne S.

Tregimi 26 nga 60

www.M1914.org

Bible for Children, PO Box 3, Winnipeg, MB R3C 2G1 Canada

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori, nëse nuk do ta shitni.

Shqip

Albanian

Shumë vite më parë, një
njeri i quajtur Jona jetonte
në vendin e Izraelit.



1

Një ditë Perëndia i tha atij të
shkojë në Ninive, që ishte qyteti
më i madh dhe më i
fuqishëm në botë.



2

Jona duhej ti paralajmëronte njerëzit atje, duke u treguar se Perëndia e dinte sa të ligj që ishin.



3

Por Jona nuk iu bind Perëndisë! Në vend që të shkante në Ninive, Jona hypi mbi një anije dhe lundroi tutje plotësisht në drejtim të kundërt, në një vend të quajtur Tarshish.



4

Zoti Perëndi dërgoi një stuhi të madhe në det. Një stuhia e furishme filloi! Detarët po kishin frikë se anija do bëhej copash dhe fundosej.




5

Stuhia po bëhej gjithnjë dhe më e fortë. Të tmerruar, detarët iu lutën perëndive të tyre dhe e hodhën gjithë ngarkesën në det për të lehtësuar anijen. Po asgjë nuk ndihmonte.



6

Jona ishte i vetmi person në bord që nuk po lutej. Përkundrazi, ai ia kishte futur gjumit në hambar; po çfarë gjumi se! Kapiteni i anijes më në fund e gjeti. "Po si mund të flesh? Çohu! Lutju Perëndisë tënd! Mbase Perëndia do të mendojë për ne dhe nuk do të shkatërrohemi".




7

Detarët shumë shpejt vendosën që sikleti i tyre kishte të bënte diçka me Jonën. Jona u tha atyre se ai po ia mbathte larg Perëndisë. Ata pyetën, "çfarë duhet të bëjmë me ty, që deti të qetësohet për ne"?



8

"Më kapni dhe më hidhni në mes të detit", u përgjigj Jona. "Sepse jam i sigurtë që kjo stuhi e madhe ka ardhur mbi ju për shkakun tim".



9

Detarët nuk donin ta hidhnin Jonan në det. Ata i dhanë fort rremave duke u përpjekur ta nxirrnin anijen në breg. Por nuk ia dolën mbanë. Mbetej vetëm një gjë për të bërë.




10

Mbasi u lutën për falje, detarët e kapën Jonan dhe e hodhën nga anija. Ndërsa Jona u zhduk nën dallgët, deti u qetësua, dhe era pushoi. Detarët e kuptuan që kjo ishte vepër e Perëndisë. Të mahnitur dhe frikësuar, ata adhuruan Perëndinë.




11

Ndërkohë, lajmëtari i pabindur pati një surprizë. I pashpresë, duke u zhytur në thellësitë e detit, Jona mendonte se asgjë nuk do e shpëtonte atë më prej mbytjes. Dhe vërtet ai do të ish mbytur - nëse Perëndia nuk kishte plane të tjera.



12

Perëndia kishte përgatitur një peshk të madh, që të gëlltiste Jonan. Peshku ishte pikërisht në kohë! Një të hapur të gojës, dhe Jona shkoi nga deti në barkun e peshkut. Jona qëndroi atje brenda tre ditë. Ai kishte mjaft kohë për tu menduar dhe lutur.



13

Tre ditë më vonë, më në fund Jona premtoi ti bindej Perëndisë. Menjëherë, Perëndia i foli peshkut, dhe ky i fundit e volli Jonan në breg.



14

Përsëri, Perëndia e urdhëroi Jonan të shkonte në Ninive për të predikuar Fjalën e Perëndisë. Kësaj here Jona shkoi! Jona hyri në qytet, duke bërë titur, "Në dyzet ditë, Ninive do të shkatërrohet".



15

Njerëzit e Ninives i besuan Fjalës së Perëndisë. Ata agjëruan, dhe u veshën me thasë për ti treguar Perëndisë që u vinte keq për mëkatet e tyre. Madje edhe mbreti e përuli veten përpara Perëndisë. Ai zbriti nga froni i tij, u vesh me thasë dhe u ul mbi hi. Ai urdhëroi që çdo njeri të kthehej nga rrugët e liga dhe dhuna, dhe të lutej që Perëndia ti falte ata.




16

Dhe Perëndia i fali ata! Duhej të ishte një ditë e mrekullueshme gëzimi në Ninive kur njerëzit e kuptuan që Perëndia i kishte falur ata. ... Por, ishte dikush që ishte shumë i zemëruar. Jona!




17

Përse ishte i zemëruar Jona? Ai i tha Perëndisë, "Unë e dija që ti je Perëndi plot hir, dhe i mëshirshëm, i ngadaltë në zemërim, dhe i madh në mirësi" Me fjalë të tjera, Jona e dinte që Perëndia gjithmonë i fal ata që pendohen për mëkatet e tyre dhe i braktisin ato duke iu bindur Fjalës së Perëndisë.



18

Me sa duket Jonës nuk i pëlqenin njerëzit e Ninives. Ai nuk donte që ata të merrnin faljen e mëkateve.



19

Jona ishte kaq i zemëruar me Perëndinë, sa që ai tha, "Ma merr jetën; sepse vdekja është më mirë për mua sesa jeta".



20

Jona u ul jashtë qytetit, duke pritur të shihte çfarë Perëndia do të bënte më pas. Zoti, Perëndi përgatiti një bimë me gjethe të mëdha. U rrit shpejt, dhe i bëri hije Jonës duke e mbrojtur nga dielli i nxehtë gjithë ditën.



21

Mëngjesin tjetër, Perëndia dërgoi një krimb, që e thau bimën. Atëherë Perëndia ngriti një erë të nxehtë dhe përvëluese që e goditi Jonan aq keq, sa që ai mendoi se do vdiste prej saj. E gjitha kjo e zemëroi edhe më shumë Jonën.



22

Pastaj Perëndia i tha Jonës, "A ke të drejtë ti të zemërohesh? Ty të erdhi keq për një bimë për të cilën nuk punove dhe nuk e bërë të rritet.



23

Mbiu brenda një dite dhe u tha për një natë. Përse nuk u dashka që Unë të kem mëshirë për Ninivenë, qytetin e madh, me mijërat e njerëzve të saj?"



24

Jona dhe Peshku i Madh

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Jonas

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkate. Denimi për mekatin është vdekja.

Perëndia na don neve aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij, Jezusin, që të vdes në Kryq dhe të paguaj dënimin tonë. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lartë në Qiell.

Nëse ti do që të pendohesh, thuaja këtë Perëndisë: Perëndi i dashur, unë besoj në Jezusin që vdiq për mua dhe jeton. Të lutem eja në jetën time dhe m'i fal mëkatet, në mënyrë që të kem jetën e re. Dhe që të jem me Ty përgjithmon. Më ndihmo që të jetoj për Ty si fëmija i Yt. Amen. Gjoni 3:16

Lexo Biblën dhe fol me Perëndinë çdo ditë!